

Sot, më 22/06/2024

KONTRATË
(TË SHOQËRISË "PREMIUM BEVERAGE DISTRIBUTION" SH.P.K)

PALA SHITËSE:

z.Elton Plaku, shtetas shqiptar, i datelindjes 11/07/1979, lindur ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identitetit tip karte me nr. Personal H90711125O.

Ketu e me poshte te cilesuar "Shitesi" ose "Pala shitesë"

PALA BLERËSE:

Znj. Ermelinda Nano, shtetase shqiptare, e datëlindjes 04/10/1978, lindur në Tirane, madhore dhe me zotesi te plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e dokumentit të identitetit tip karte me nr. Personal H86004053O.

Ketu e me poshte, te cilesuar "Bleresi", ose "Pala blerese".

BAZA LIGJORE:

1-Ligji 9901 date 14-04-2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare".
2-Vendimi nr. 7 date 22/06/2024 i Asamblese se Ortakeve te shoqerise " PREMIUM BEVERAGE DISTRIBUTION " SHPK.

Neni 1

Objekti i Kontratës

Shitja e kuotave te kapitalit te shoqerise "PREMIUM BEVERAGE DISTRIBUTION" shpk ne masen totale 50% nga ana e ortakut Elton Plaku dhe blerja e tyre nga blerësi Ermelinda Nano.

Neni 2


Permbajtja e Kontratës


"PREMIUM BEVERAGE DISTRIBUTION" shpk eshte e rregjistruar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me adrese kryesore ne Tirane, Rruga Mihal Ballkameni, Objekti Nr.1, Hyrja Nr.1, Kati i pare, me numer NIPT M43712601J, me perfaqesues ligjor Elton Plaku, me aktivitet "Tregti me shumicë dhe pakice e pijeve alkolike dhe e pijeve te tjera (vere,birre e pije te tjera)" etj, me ortak te vetem:

1. Z. Elton Plaku: zotërues i 1 kuote me 100% të pjesëve te kapitalit

Kapitali thelemtar i kesaj shoqerie eshte 100 leke (njqind).

Me kete kontrate shitblerje, shitesi Elton Plaku i shet bleresit Ermelinda Nano, 50% te kuotave qe atij i perkasin ne kapitalin e kesaj shoqerie. Shitja e kuotave te kapitalit themeltar te kesaj shoqerie, ne masen 50%, nga ana e ortakut Elton Plaku sjell humbjen e te drejtes se pronesisë se tij mbi keto kuota si pasoje e ketij trasanksioni shitje. Nga ana e tyre blerësi Ermelinda Nano eshte plotesisht dakort qe te bleje kuotat e mesiperme, ne masen 50%.

ELTON PLAKU


Ermelinda Nano


Neni 3

Cmimi dhe Kryeria e pagesave

CMIMI I SHITJES: 50 leke (pesedhjetë)

Kjo vlefte do të paguhet plotesisht, kesh në dore, pa asnjë lloj pretendimi nga palet, brenda muajit pasardhës.

Palët deklarojnë se njohin e pranojnë të gjitha detyrimet që shoqëria ka ndaj shtetit dhe pala blerëse deklaron se i mer për sipër shlyerjen e këtyre detyrimeve. Detyrimet e pales shitëse i bashkëlidhen kësaj kontrate.

Neni 3

Efektet e Kontrates

Kjo kontratë ka forcën e ligut për palët kontraktuese. Nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate të gjitha detyrimet e shoqërisë i kalojnë blerësit.

Kontrata ka efekt ndaj të tretëve dhe subjekteve të tjera sipas parashikimeve të ligut.

Neni 4

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Cdo mosmarrëveshje që mund të lind gjatë zbatimit të kësaj kontrate palët kanë rënë dakort, ta zgjidhin me anë bisedimesh. Në rast të kundërt palët do të drejtohen për zgjidhje gjykatës së rrethit gjyqësor Tirane.

Neni 5

Kalimi i pronësisë

Me firmosjen e kësaj kontrate, miratimin e saj në mbledhjen e asamblesë së ortakëve dhe depozitimin e saj në QKB, blerësi Ermelinda Nano, njihet ortakë e shoqërisë dhe pronarë të 1 kuote në masën 50%.

Me nënshkrimin e këtij akti, shitësi, e humbet pronësinë e tij në kuotat e kapitalit të shitura, duke mos pasur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi këto kuota.


Ndërsa blerësi njihet pronar i ligjshëm i këtyre kuotave.

Ky akt është perpiluar në katër kopje origjinale me vlerë të barabartë, lexuar nga palet dhe nënshkruar me vullnetin e tyre të lire.

Shenim: Kjo kontratë shfuqizon cdo kontratë tjetër të mëparshme të nënshkruar për këtë qëllim.

SHITËS

Elton Plaku





BLERËS

Ermelinda Nano

